

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
“MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR SHPALLJEN E ZONAVE
TË VEÇANTA TË RUAJTJES”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është të përcaktojë rregullat e hollësishme, procedurat dhe formatin për propozimin e Zonave të Veçanta të Ruajtjes (ZVR), si zonat e ardhshme “Natura 2000” për Shqipërinë, në zbatim të dispozitave të Ligjit “Për Zonat e Mbrojtura” nr. 81/2017, datë 4.5.2017. Neni 29 i këtij ligji përcakton disa kritere të përgjithshme dhe parashikon që kriteret e vlerësimit dhe të shpalljes së ZVR, do të realizohet me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave.

Projektvendimi i propozuar është hartuar në kuptim të pikës 6, të nenit 29, të ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.

Objektivi është që të plotësohet baza ligjore kombëtare për ngritjen e rrjetit ekologjik Natura 2000 të ZVR me interes për Komunitetin Evropian në vend.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim dhe miratim bën pjesë në matricën analitike të projektakteve për vitin 2019. Ai është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për mbrojtjen e florës dhe faunës së egër dhe biodiversitetit. Miratimi i këtij projektvendimi kontribon gjithashtu në zbatimin e masave të parashikuara në Dokumentin e Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit deri në vitin 2020 për Shqipërinë dhe në zbatimin e PKIE për fushën e mbrojtjes së natyrës.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi synon detajimin e kriterëve të shpalljes, procedurave të propozimit dhe miratimit si dhe formatit për propozimin e ZVR, në përputhje

me formatin e kërkuar nga Komisioni Evropian, për paraqitjen e listës dhe dokumentacionit paraprak për çdo zonë të propozuar Natura 2000 për Shqipërinë, si pjesë e rrjetit ekologjik pan-evropian, në përputhje me dispozitat e ligjit të ri për zonat e mbrojtura.

Konkretisht, projektvendimi formulon dispozita të detajuara për kriteret minimale që duhet të plotësojnë ZVR, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 29 të Ligjit “Për zonat e mbrojtura”. Këto parashikime janë në përputhje me Direktivën e Habitaveve (92/43/EEC) si dhe detajon procedurat që duhet të ndiqen nga MTM në bashkëpunim me AKZM dhe AKM, për përgatitjen e listës së zonave Natura 2000 për Shqipërinë, që do t’i paraqitet Komisionit Evropian në momentin e anëtarësimit në BE.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën dhe me kuadrin ligjor kombëtar të fushës së mbrojtjes së natyrës dhe hartohet në zbatim të nenit 29, pika 6 të Ligjit “Për Zonat e Mbrojtura” nr. 81/2017, datë 4.5.2017.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi synon transpozimin e Vendimin Implementues të Komisionit i 11 Korrik 2011 “Për formatin e informacionit për zonën për zonat Natura 2000”; Celex Nr. 32011D0484, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 198, datë 30.07.2011.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi konsiston në formulimin e kriterëve të detajuara për ZVR në pjesën hyrëse të tij, më pas jepen kategoritë e disa llojeve ekzistuese të zonave të mbrojtura që mund të plotësojnë kriteret për t’u klasifikuar si ZVR dhe formati në të cilin do të hidhen të dhënat dhe informacioni për ZVR si zona potenciale Natura 2000.

Më tej duke filluar nga pika 5, përcaktohet procedura dhe identifikohen institucionet përgjegjëse për përgatitjen e listës paraprake dhe kryerjen e studimeve, propozimeve dhe procedura e miratimit dhe e përcjelljes pranë Komisionit Evropian, në përputhje me kriteret dhe dispozitat e Ligjit “Për Zonat e Mbrojtura”.

Më pas në projektvendim shprehet se hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 897, datë 21.11.2011 “Për miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes”, shfuqizohet.

Në fund, projektvendimi përcakton institucionet që ngarkohen për zbatimin e tij.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe me mbështetjen e projektit Natural (IPA 2013).

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare të menjëhershme shtesë për buxhetin e shtetit, pasi aktualisht në dispozicion të këtij procesi ka një buxhet të dedikuar nga projekti Natural (IPA 2013), për identifikimin e zonave potenciale fillestare ZVR për Shqipërinë për vitin 2019-2020.

Në vijim MTM, AKZM dhe AKM do të shikojnë mundësinë e sigurimit të fondeve të tjera nga projekte që janë në zbatim dhe nga projekte të reja. Gjithashtu me hapjen e negociatave do të planifikohet një buxhet në programin mbrojtja e mjedisit dhe mbrojtja e pyjeve për të filluar konsolidimin e listës paraprake dhe të dhënave në përditësim dhe rishikim.

MINISTRI

Blendi KLOSI

Konceptoi: E. Ramaj, Përgj. Sektori
Miratoi: R.Baduni, Drejtor
E.Tarelli, Drejtor
Z.Dedej, Drejtor i Përgjithshëm
A.Karaja, Drejtor i Përgjithshëm
P. Abeshi, Drejtor i Përgjithshëm

Konfirmoi: A. Kamenica, Sekretar i Përgjithshëm

